



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

Tiranë, më

**VENDIM**  
**Nr. 58, datë 15.02.2022**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM**  
**GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A. NJOHURITË LIGJORE

#### 1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret”.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:*** Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, gjatë gjykimit në shkallë të parë.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes, pothuajse në të gjitha vendimet e analizuara, vlen të theksohet se pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, gjykim penal themeli, apo kërkesë penale*), apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale, apo gjykim si shkallë e dytë mbi bazë ankimi në çështjet civile*), rrethanat e fakteve parashtrihen në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, pavarësisht se nuk rezulton si një nën-pjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”. Por, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes, në përputhje me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht. Tipar karakteristik i gjyqtarës është analiza e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në çështjet civile. Pra, në funksion të analizës ligjore dhe argumentit të përdorur drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjyqtarja bën një analizë të provave mbi të cilat ajo mbështetet, duke veçuar pjesë të përmbajtjes së tyre që i shërbejnë provueshmërisë së fakteve objekt gjykimi.<sup>1</sup>

***Në lidhje me identifikimin e natyrës së çështjes:*** Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të të cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, pra, nëse natyra juridike e çështjes është civile, administrative, apo penale. Gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën lëndore dhe përbën një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë, konform nenit 467 paragrafi i parë, shkronja “a” të K.Pr.Civile. Në këtë kontekst, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke e shprehur në mënyrë eksplicite, gjyqtarja e përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi.

***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:*** Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori: (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) **Në vendimet civile** (*mosmarrëveshje pronësie, shpërblim dëmi, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, kundërshtim veprimesh përbarimore apo përmbushje detyrimi që rrjedhin nga kontratat*), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse, nga ku evidentohet konkretisht:

---

<sup>1</sup> Vendimi nr. 141, datë 02.04.2015 dhe vendimi nr.77, datë 01.03.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

- a) Në çështjen me objekt pavlefshmëri e titujve ekzekutivë të faturave të energjisë elektrike,<sup>2</sup> gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale njëkohësisht (nenin 609 të K.Pr.Civile) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, dhe po kështu, ligjin e posaçëm nr. 8662, datë 18.09.2000, mbi përcaktimin e faturës tatimore si titull ekzekutiv.
- b) Në çështjen me objekt përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit,<sup>3</sup> gjyqtarja, përpos identifikimit të neneve 1113, 1114, 1127 të K.Civil, lidhur me rregullat e posaçme për kontratën e sigurimit, neneve 419, 420, 455 të K.Civil, lidhur me rregullat e përgjithshme të detyrimeve civile, nenit 690 të K.Civil, në lidhje me fuqinë ligjore të kontratave të lidhura rregullisht nga palët, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes i referohet edhe ligjit nr.9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar.
- c) Në çështjen me objekt pavlefshmërinë e kontratës së shitjes,<sup>4</sup> gjyqtarja identifikon dispozitat materiale relevante, si dhe dispozitat e tjera materiale civile në funksion të konkludimit se veprimet juridike të kryer për tjetërsimin e truallit nuk janë të vesuara e nuk përbëjnë shkak pavlefshmërie absolute, sikurse pretendohet në ankim nga pala paditëse. (ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, ligjin nr.7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”).
- d) Në çështjen me objekt njohjen, në referim të nenit 32/c të K.Pr.Civile,<sup>5</sup> gjyqtarja në mbështetje të arsyetimit të saj lidhur me njohjen e marrëdhënies së punës, identifikon si ligj të zbatueshëm edhe ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.
- e) Në çështjen me objekt kundërshtim i veprimeve përmbartimore,<sup>6</sup> gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale njëkohësisht (nenin 606 të K.Pr.Civile) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për të garantuar realizimin e të drejtave të kreditorëve, duke parashikuar mundësinë e ndëshkimit administrativ të personave që pengojnë përmbartuesin në përmbushjen e detyrës së tij.

Në dy raste evidentohet se gjyqtarja nuk ka identifikuar apo cituar ndonjë dispozitë ligjore, materiale apo procedurale, në lidhje me zgjidhjen e çështjes, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e thjeshtë e objektit të padisë të trajtuar.<sup>7</sup>

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtarja ka referuar dhe cituar si pjesë të arsyetimit të vendimit, nenet 179 dhe 201 të K.Pr.Civile, në lidhje me situatat e parashikuara që mundësojnë pushimin e gjykimit, në rast të mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të arsyeshme, apo për shkak të heqjes dorë nga gjykimi (vendimi nr.612, datë 07.11.2013, vendimi nr. 1356, datë 15.10.2019). Gjyqtarja ka referuar dhe cituar nenin 70 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerën provuese të vendimit penal të formës së prerë, në shqyrtimin e pasojave civile (vendimi nr.816, datë 18.03.2014).

<sup>2</sup> Vendimi nr. 640, datë 14.11.2013 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>3</sup> Vendimi nr. 816, datë 18.03.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>4</sup> Vendimi nr. 187, datë 26.03.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 229, datë 16.04.2015 i Gjykatës s Apelit Shkodër.

<sup>6</sup> Vendimi nr. 343, datë 02.06.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>7</sup> Vendimi nr. 343, datë 22.06.2016 dhe nr. 16, datë 19.01.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër

Nuk konstatohet që gjyqtarja të citojë dhe analizojë dispozita procedurale civile lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës, pasi këto çështje nuk rezultojnë që të jenë bërë objekt i ankimit dhe shqyrtimit gjyqësor.

(ii) **Në vendimet penale**, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit. Konkretisht, gjyqtarja identifikon nenin 141/a/2 të K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, nenin 186/2 në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”,<sup>8</sup> identifikon nenin 89 të K.Penal në lidhje me akuzën “Plagosja e lehtë me dashje”,<sup>9</sup> nenin 141 të K.Penal në lidhje me akuzën “Vjedhja me pasojë vdekjen”, nenin 278/5 të K.Penal në lidhje me akuzën “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”,<sup>10</sup> nenin 76 të K.Penal në lidhje me akuzën “Vrasja me dashje”, nenin 278/4 të K.Penal në lidhje me akuzën “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”,<sup>11</sup> nenin 145 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Mastrimi në sigurime”. Gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të ligjeve të posaçme, në funksion të argumentimit lidhur me anën objektive të veprave penale, konkretisht: ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,<sup>12</sup> nenet 2, 3 dhe 4 të ligjit nr. 99, datë 18.03.2013, “Për armët”.<sup>13</sup>

Në çdo rast, gjyqtarja referon dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (neni 47 i K. Penal), rrethanat lehtësuese dhe rënduese (nenet 48, 49 dhe 50 të K. Penal), dispozitat lidhur me dënimet alternative (neni 59 i K.Penal), etj.

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit apo themeli*) apo ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*) gjyqtari identifikon dispozitat procedurale si më poshtë:

- nenin 403 të K.Pr.Penale lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 369 të K.Pr.Penale në lidhje me leximet e lejueshme të akteve të marra gjatë hetimeve paraprake; nenin 428 të K.Pr.Penale në lidhje me situatat e përcaktuara në mënyrë taksative për kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;<sup>14</sup>
- nenin 413 të K.Pr.Penale në lidhje me dispozitën procedurale që disiplinon mënyrën e paraqitjes së ankimit, nenin 420 të K.Pr.Penale lidhur me mospranimin e ankimit;<sup>15</sup>
- nenin 152 të K.Pr.Penale në lidhje me çmuarjen e provave dhe vlerën e tyre provuese;<sup>16</sup>

<sup>8</sup> Vendimi nr. 180, datë 21.04.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 29, datë 23.01.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>10</sup> Vendimi nr. 77, datë 01.03.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>11</sup> Vendimi nr. 141, datë 02.04.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>12</sup> Vendimi nr. 319, datë 10.07.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>13</sup> Vendimi nr. 141, datë 02.04.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>14</sup> Vendimi nr. 141, datë 02.04.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>15</sup> Vendimi nr. 29, datë 23.01.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 180, datë 21.04.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

- nenin 54 të K.Pr.Penale në lidhje me mundësinë e realizimit të mbrojtjes së disa të pandehurve nga i njëjti mbrojtës, përveçse në rastet kur ka papajtueshmëri të interesave mes të pandehurve.<sup>17</sup>

*Sa i përket konfliktit të normave*, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit, lidhur me zgjidhjen e çështjes.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, në citimin dhe analizën e normave respektive, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjatë gjykimit të çështjes ajo ka njohuritë bazë mbi parimet e përgjithshme të aksesit në gjykatë, pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të drejtën e mbrojtjes dhe të kontradiktoritetit. Megjithatë, ajo nuk përdor rregullisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës. Në*

<sup>17</sup> Vendimi nr. 194, datë 07.05.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

*një rast, gjyqtarja përmend parimin e sigurimit të një mbrojtje efektive joformale për të pandehurin në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Në këtë rast përmendja e këtij parimi nuk ka qenë vetëm si njohuri teorike e saj, pasi në tekstin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është konsideruar si shkelje procedurale fakti që gjykata e shkallës së parë nuk ka garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor për t'i siguruar të pandehurit mbrojtje me avokate të paanshëm (mes të pandehurve ka pasur papajtueshmëri interesash dhe nuk mund të mbroheshin nga i njëjti avokat neni 54/1 i K.Pr.Penale), duke prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim (shih dosja 2) dhe në një rast tjetër është trajtuar edhe parimi i paanshësisë së gjykatës, duke prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues (shih dosja 3). 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara tregojnë se ajo ka shqyrtuar çështje gjyqësore që lidhen me kontratën e sigurimit (shih dokumentin 1), përgjegjësinë penale për veprat penale të vrasjes me dashje (shih dokumenti 2), të vjedhjes me pasojë vdekjen (shih dokumenti 3), të plagosjes së lehtë me dashje (shih dosja 1), të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armeve të ftohta në automjet dhe drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt (shih dosja 2), për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror (shih dosja 3) dhe për kundërshtimin e pasaktësisë së dokumentit (shih dosja 4 dhe 5)”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj.

Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk bëhet pa e shoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur, në shërbim të të cilit ato citohen.

Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht interpreton normën ligjore konkrete ndaj faktit juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, duke nxjerrë konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm***

(i) **Në vendimet civile:** Përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- Gjyqtarja interpreton në përputhje me rrethanat e fakteve dhe provave të administruara, dispozitat materiale (*nenin 1113 të K.Civil*) në lidhje me përkufizimin e kontratës së

sigurimit, (*nenin 1114 të K.Civil*) në lidhje me formën e lidhjes dhe elementët e kontratës së sigurimit, (*nenin 1127 të K.Civil*) në lidhje me barrën e provës që ka pala paditëse, për të provuar ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.<sup>18</sup>

- Gjyqtarja interpreton në mënyrë literale kushtet dhe kriteret e padisë së rivendikimit (*neni 296 i K.Civil*). Pas interpretimit teorik që i bëhet nga ana e gjyqtarës dispozitës relevante zbatuese në rastin konkret, i analizon këto kriteret në përputhje me faktin juridik dhe provat e administruara në gjykim, për të arritur në konkluzionin logjik se jemi para lirimit dhe dorëzimit të sendit, pasi përmbushen në mënyrë kumulative të gjitha kriteret ligjore të tij.<sup>19</sup>
- Në funksion të arsyetimit ligjor, gjyqtarja interpreton dispozitën materiale (*neni 92/a të K.Civil*) në lidhje me pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, që vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; interpreton dispozitën materiale të ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995, "Për shitblerjen e trojeve", të ligjit 7698, datë 15.04.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", për të arritur në konkluzionin se kontrata e shitjes së truallit në favor të të paditurve, buron nga një akt i marrë mbi bazën e dispozitave ligjore.<sup>20</sup>

(ii) **Në vendimet penale:** Në disa prej vendimeve penale gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (nenet 76, 82, 278/4, 145, 141,141/a të Kodit Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përqsaur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.<sup>21</sup> Në vendimet e tjera, nuk konstatohet që të jetë bërë interpretim i normës relevante penale në lidhje me veprat penale përkatëse që u atribuohen të pandehurve, (*p.sh nenit 279/2, nenit 291, apo nenit 89 të K.Penal*), kjo për shkak të mënyrës së disponimit të gjykatës së apelit, mbi mospranimin e ankimit, apo prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për shkak të mosrespektimit të të drejtave të të pandehurit për një mbrojtje efektive në proces.

Evidentohet interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47 dhe 59 të K.Penal*), në të gjitha ato raste kur shkak i ankimit ka të bëjë pikërisht me masën e dënimit, ose me aplikimin apo jo të alternativave të dënimit.

***Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale*** evidentohet se gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normave procedurale, kryesisht në lidhje me:

- llojin e gjykimit të aplikuar (gjykim i zakonshëm apo i shkurtuar), ku në çdo rast referohet neni 403 i K.Pr.Penale dhe jepet kuptimi i tij, si dhe kushtet për pranimin ose

<sup>18</sup> Vendimi nr. 816, datë 18.03.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>19</sup> Vendimi nr. 345, datë 02.06.2015 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>20</sup> Vendimi nr. 187, datë 26.03.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

<sup>21</sup> Vendimi nr. 141, datë 02.04.2015, vendimi nr. 319, datë 10.07.2014, vendimi nr.77, datë 01.03.2016 dhe vendimi nr.180, datë 21.04.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër.



jo të kërkesës për procedim me këtë lloj gjykimi, duke referuar në mbështetje të interpretimit të ligjit procedural edhe qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin Unifikues nr. 2, datë 29.01.2003;<sup>22</sup>

- interpreton dispozitën procedurale të vendimmarrjes së gjykatës së apelit (*neni 428 të K.Pr.Penale*) në përputhje edhe me kërkimet e të pandehurit për kthimin e çështjes për rigjykim, duke përcaktuar situatat e parashikuara në mënyrë taksative në rastet e disponimit për kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë;<sup>23</sup>
- interpreton nenin 413 të K.Pr.Penale në lidhje me dispozitën procedurale që disiplinon mënyrën e paraqitjes së ankimit, duke konkluduar se ndodhemi para rastit të mospranimit të ankimit (*neni 420/1 të K.Pr.Penale*) për shkak se i pandehuri nuk ka respektuar rregullat e paraqitjes së ankimit.<sup>24</sup>
- interpreton nenin 70 të K.Pr.Penale, në lidhje me vlerën provuese që ka vendimi penal i formës së prerë, në shqyrtimin e pasojave civile, duke konkluduar se veprimet hetimore të kryera nga organi i akuzës nuk përbëjnë shkak për përjashtimin nga detyrimi të siguruesit,<sup>25</sup> etj.

***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.*** Evidentohet se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve për interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, në disa prej vendimeve të analizuara. Konkretisht, në lidhje me: (i) procedimin me gjykim të shkurtuar, është referuar, së bashku me bazën ligjore procedurale, Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 29.01.2003; (ii) në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale “Vjedhja me pasojë vdekjen”, është referuar Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 30.09.2011.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, evidentohet se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet duke i përmendur ato shprehimisht dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit.

## **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

---

<sup>22</sup> Vendimi nr. 141, datë 02.04.2015 dhe vendimi nr.77, datë 01.03.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër;

<sup>23</sup> Vendimi nr.77, datë 01.03.2016 i Gjykatës së Apelit Shkodër;

<sup>24</sup> Vendimi nr.29, datë 23.01.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër;

<sup>25</sup> Vendimi nr.816, datë 18.03.2014 i Gjykatës së Apelit Shkodër;

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.B. ARSYETIMI LIGJOR**

### **1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në mënyrë të veçantë në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh. në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine,<sup>26</sup> por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

### **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

---

<sup>26</sup> Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Vendimet përfundimtare ajo i strukturon sipas elementeve të kërkuar nga ligji procedural, duke ruajtur strukturë të standardizuar. Në pjesën hyrëse të vendimit, ajo shënon datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë, gjeneralitetet e plota të palëve apo aktet e përfaqësimit të tyre (shih 3 dokumentet dhe dosjet 1, 2 3, 4 dhe 5). Pjesa arsyetuese hartohet prej saj me tekst unik, përgjithësisht me paragrafë të panumërtuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës dhe respektimit të normës ligjore nga gjykatat më të ulëta dhe kur është rasti identifikon shkeljen me pasoje prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, pasi nuk është siguruar zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor (shih dosja 2 dhe 3). Dispozitivi i vendimit tregon qartësisht çfarë ka vendosur Gjykata e Apelit, por në dispozitiv mungon disponimi për shpenzimet gjyqësore, si dhe nuk tregohet e drejta dhe afati i rekursit. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor”*.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja në hartimin e vendimeve gjyqësore ndjek një strukturë të qartë, të qëndrueshme, dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të së cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi, si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit

*Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet/shkaqet e ankimit të subjekteve në gjykimin në Apel.*

*Pjesa përshkruese – arsyetuese është e ndarë në disa nën-pjesë, edhe pse vizualisht jo me tituj të përcaktuar, si p.sh. “rrethanat e faktit”, “ligji i zbatueshëm”, “analiza juridike”, nga mënyra e pasqyrimin të tyre në vendim konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nënndarje. Në pjesën përshkruese-arsyetuese analizohen në mënyrë të detajuar: rrethanat e fakteve të çështjes, siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, rrethanat procedurale në gjykimin në apel dhe vlerësimi i gjykatës së apelit mbi shkaqet e ankimit, në të cilën gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionin e saj.*

*Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, si dhe data e shpalljes së vendimit. Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe në nenit 466 të K.Pr.Civile dhe vendimet penale përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 383 të*

K.Pr.Penale. Po kështu, vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëri paragraf në tjetrin dhe nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

## **1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetim ligjor.... Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor*”.

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka

evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo të çështjes penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale.

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Vendimet gjyqësore dominohen nga pjesa analitike e analizës dhe jo nga ajo përshkruese e fakteve. Jo vetëm në aspektin e profesionistit, por edhe për një lexues të arsyeshëm, pavarësisht zgjidhjes së çështjes e cila vlerësohet nga një gjykatë më e lartë, argumentet e paraqitura, veç interpretimit ligjor mbi fakte të provuara, bazohen në arsye dhe logjikë. Gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë analizës së çdo pretendimi të ngritur në ankim, përpos detyrimit për të shqyrtuar ose jo në tërësi çështjen.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtares”**

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

## **2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i*

*cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.*

## **2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË**

### **2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} përgjithësisht ka qenë brenda afatit standard apo ligjor”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendimeve të administruar për shkak të ankesave.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu, edhe për çështjet civile, në përgjithësi, nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes në Apel.<sup>27</sup>

---

<sup>27</sup> Afati ligjor 60 ditë i parashikuar për përfundimin e çështjeve në gjykimin në Apel në nenin 609 të K.Pr.Civile ka hyrë në fuqi në Korrik 2016, pra ky afat ligjor gjykimi nuk i përket periudhës objekt vlerësimi.

Konkretisht, për kërkesën penale me objekt “caktimin e masës së sigurimit”, neni 249 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se kërkesa shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve. Në rastin konkret (vendimi nr.32, datë 13.02.2014), kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Apelit Shkodër në datën 05.02.2014, dhe ka përfunduar në datën 13.02.2014 (8 ditë), duke respektuar afatin ligjor dhjetë ditor, të përcaktuar në nenin 249, pika 5, të K.Pr.Penale.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar çështjes për të cilën ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, rezulton se ky afat është respektuar. Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjes së analizuar më lart, aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues pikëzohet në nivelin maksimal.

### **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjen e analizuar për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, në kushtet kur nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor, gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.*

### **2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues



do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendimeve të administruar për shkak të ankesave.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} përgjithësisht ka qenë brenda afatit standard apo ligjor. Në përlllogaritjen e kohës efektive të mbajtjes për gjykim të dosjes nga gjyqtarja është përlllogaritur data e shpalljes së listës së gjykimeve nga kryetari i gjykatës, me të cilën caktohet seanca e parë gjyqësore (në 5 dosjet e vëzhguara rezultoi se edhe për çështjet penale seanca e parë është caktuar nga kryetari i gjykatës). Konkretisht, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 5 ditë (shih dosjen 1), 1 muaj e 26 ditë (shih dosjen 2), 1 muaj e 1 ditë (shih dosjen 3 dhe 5) dhe 1 muaj e 23 ditë (shih dosjen 4) dhe 16 ditë (shih dosjen 5). Ndërsa në 3 dokumentet ligjore, edhe pse kohëzgjatja e gjykimit nuk mund të përcaktohet, pasi data e seancës së parë gjyqësore caktohet nga kryetari në listën e shpallur të nënshkruar prej tij dhe në tekstin e vendimit nuk ka të dhëna në lidhje me këtë, apo me datën e shartimit të çështjes, për vetëm është shënuar koha e regjistrimit të çështjes gjyqësore në Gjykatën e Apelit, duhet theksuar se edhe në mungesë të këtyre treguesve 2 çështje janë gjykuar brenda afatit standard (shih dokumenti 2 dhe 3) dhe vetëm një çështje është në tejkalim të afatit (shih dokumenti 1). Në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimit duhet evidentuar se nga 6 ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës {...} gjatë periudhës së rivlerësimit konstatohen se vetëm 1 ankesë, e vitit 2014, është për zvarritje gjykimi dhe mosrespektimin formal të ligjit, e cila pas verifikimit është arkivuar pasi pretendimet janë gjetur të pabazuara (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore)”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur brenda standardeve minimale kohore, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD, dhe duke i ndarë sipas kategorisë çështjet, prej nga rezultoi se:

#### Çështje penale:

- Dosja 1 - që i përket çështjes me nr. 133/613 Regj. Themeltar, është regjistruar në gjykatë në datën 05.09.2013 dhe ka përfunduar në datën 23.01.2014, pra gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 18 ditë, tej standardit minimal kohor prej 2 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (për veprat penale të kategorisë kundërvajtje). Nga dosja nuk rezultoi që të jetë disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, por pavarësisht këtij konstatimi, pas caktimit me short, rezultoi se çështja është nxjerrë për gjykim në datën 18.12.2013, referuar datës së shpalljes për njoftimin e palëve. Pra, rezultoi se çështja ka përfunduar brenda afatit standard minimal kohor prej 2 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.
- Dosja 2 - që i përket çështjes me nr. 273 (00035) Regj. Themeltar, është regjistruar në gjykatë në datën 09.01.2015 dhe ka përfunduar në datën 07.05.2015, pra çështja ka përfunduar brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (për veprat penale të kategorisë krime), duke u nisur nga

data e regjistrimit të çështjes, si edhe referuar datës së nxjerrjes për gjykim (11.03.2015);

- Dosja 6 - që i përket çështjes me nr. 351 (00142) Regj. Themeltar, është regjistruar në gjykatë në datën 21.03.2014 dhe ka përfunduar në datën 10.07.2014, pra çështja ka përfunduar brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (për veprat penale të kategorisë krime), duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes, si edhe referuar datës së nxjerrjes për gjykim (13.06.2014);
- Dosja 11 - që i përket çështjes me nr. 555 (00407) Regj. Themeltar, është regjistruar në gjykatë në datën 13.05.2015 dhe ka përfunduar në datën 21.04.2016, pra gjykimi ka zgjatur 11 muaj 8 ditë, tej afatit standard minimal kohor prej 6 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (për veprat penale të kategorisë krime). Nga dosja nuk rezulton që të jetë disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, por pavarësisht këtij konstatimi, pas caktimit me short, rezulton se çështja është nxjerrë për gjykim në datën 13.01.2016, referuar datës së shpalljes për njoftimin e palëve. Pra, rezulton se çështja ka përfunduar brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.
- Vendimi 2 - që i përket çështjes me nr. 345 (00134) Regj. Themeltar, është regjistruar në gjykatë në datën 06.02.2015 dhe ka përfunduar në datën 02.04.2015, pra gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 25 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (për veprat penale të kategorisë krime - në minimum jo më pak se 10 vjet).
- Vendimi 3 - që i përket çështjes me nr. 585 (00080) Regj. Themeltar, është regjistruar në gjykatë në datën 15.01.2016 dhe ka përfunduar në datën 01.03.2016, pra gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 14 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD (për veprat penale të kategorisë krime - në minimum jo më pak se 10 vjet).

#### Çështje civile:

- Dosja 3 - që i përket çështjes me nr. 986/1488 (00425) Regj. Themeltar, është regjistruar në datën 18.05.2012 dhe ka përfunduar në datën 07.11.2013. Gjykimi ka zgjatur 1 vit, 5 muaj e 20 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim, datë 08.10.2013, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 30 ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor për gjykimin prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të KLD;
- Dosja 4 - që i përket çështjes me nr. 220/1658 (00260) Regj. Themeltar, është regjistruar në datën 18.04.2014 dhe ka përfunduar në datën 16.04.2015. Gjykimi ka zgjatur 11 muaj e 28 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim, datë 11.03.2015, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 1 muaj e 5 ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor për gjykimin prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të KLD;
- Dosja 5 - që i përket çështjes me nr. 583/1252 (00732) Regj. Themeltar, është regjistruar në datën 02.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 19.01.2016. Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 17 ditë, pra çështja ka përfunduar brenda afatit standard minimal

kohor prej 6 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes, si edhe referuar datës së nxjerrjes për gjykim (24.12.2015);

- Dosja 7 - që i përket çështjes me nr. 547/968/1448 (00821) Regj. Themeltar, është regjistruar në datën 04.10.2011 dhe ka përfunduar në datën 14.11.2013. Gjykimi ka zgjatur 2 vjet 1 muaj e 10 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim, 08.10.2013, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 1 muaj e 6 ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor për gjykimin prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të KLD;
- Dosja 8 - që i përket çështjes me nr. 340/1799 (00444) Regj. Themeltar, është regjistruar në datën 02.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 02.06.2015. Gjykimi ka zgjatur 11 muaj. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim, 11.05.2015, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 22 ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor për gjykimin prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të KLD;
- Dosja 9 - që i përket çështjes me nr. 356/1815 (00469) Regj. Themeltar, është regjistruar në datën 16.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 02.06.2015. Gjykimi ka zgjatur 10 muaj e 17 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim, 11.05.2015, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 22 ditë, pra brenda afatit standardi minimal kohor për gjykimin prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të KLD;
- Dosja 10 - që i përket çështjes me nr. 270/900 (00336) Regj. Themeltar, është regjistruar në datën 17.04.2015 dhe ka përfunduar në datën 22.06.2016. Gjykimi ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 5 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim, 13.05.2016, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 1 muaj e 9 ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor për gjykimin prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të KLD;
- Vendimi 1 - që i përket çështjes me nr. 1142/1660 (00634) Regj. Themeltar. Sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi, rezulton se data e regjistrimit është 13.07.2012 dhe data e përfundimit të çështjes 18.03.2014. Gjykimi ka zgjatur 1 vit, 8 muaj e 5 ditë. Në kushtet kur nga vendimi nuk rezultojnë të dhëna lidhur me datën e nxjerrjes së çështjes në gjykim, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar tej standardit minimal kohor prej 6 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- Vendimi i administruar për shkak të ankesave - që i përket çështjes me nr. 1200/1984 (00628) Regj. Themeltar. Sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi rezulton se data e regjistrimit është 25.07.2013 dhe data e përfundimit të çështjes 26.03.2014. Gjykimi ka zgjatur 8 muaj e 1 ditë, duke përfshirë në këtë periudhë edhe lejen vjetore të gjykatës në muajin gusht, si dhe afatin 3 javor të afishimit të shpalljes, para ditës së seancës gjyqësore. Në rast se do të zbritej koha e lejes vjetore dhe koha e afishimit të shpalljes, do të rezultonte se gjykimi ka zgjatur 6 muaj, brenda afatit standard minimal kohor të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, viti 2010 të KLD.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 15 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër parashtrohet më sipër, 14 nga 15 çështjet e vëzhguara kanë përfunduar brenda afatit standard minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve për të cilat gjykimi ka përfunduar tej standardit minimal kohor, në

raport me numrin e çështjeve të analizuara (1/15) rezulton se çështjet e shqyrtuara në tejkalim të standardit minimal kohor, përbëjnë rreth 6% të tyre.

Para ndryshimeve të K.Pr.Civile me Ligjin 38/2017, nxjerrja e çështjeve civile për gjykim bëhej nga Kryetari i Gjykatës, i cili urdhëronte nxjerrjen e çështjeve për gjykim, nëpërmjet shpalljeve të afishuara në Gjykatën e Apelit dhe gjykatat respektive të rretheve gjyqësore, nëpërmjet afishimit të shpalljeve, 3 javë para datës së seancës gjyqësore (neni 460 i K.Pr.Civile para ndryshimeve). Në këtë situatë edhe nëse do të llogaritej përfshirja e këtij afati 3 javor, në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve si më lart, përsëri do të arrihej në të njëjtin konkluzion në lidhje me respektimin e standardit minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja vlerësohet në nivelin “Mbi 0 - 10%”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

## **2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} përgjithësisht ka qenë brenda afatit standard apo ligjor. Në përlllogaritjen e kohës efektive të mbajtjes për gjykim të dosjes nga gjyqtarja është përlllogaritur data e shpalljes së listës së gjykimeve nga kryetari i gjykatës, me të cilën caktohet seanca e parë gjyqësore (në 5 dosjet e vëzhguara rezulton se edhe për çështjet penale seanca e parë është caktuar nga kryetari i gjykatës). Konkretisht, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 5 ditë (shih dosjen 1), 1 muaj e 26 ditë (shih dosjen 2), 1 muaj e 1 ditë (shih dosjen 3 dhe 5) dhe 1

muaj e 23 ditë (shih dosjen 4) dhe 16 ditë (shih dosjen 5). Ndërsa në 3 dokumentet ligjore, edhe pse kohëzgjatja e gjykimit nuk mund të përcaktohet, pasi data e seancës së parë gjyqësore caktohet nga kryetari në listën e shpallur të nënshkruar prej tij dhe në tekstin e vendimit nuk ka të dhëna në lidhje me këtë, apo me datën e shortimit të çështjes, për vetëm është shënuar koha e regjistrimit të çështjes gjyqësore në Gjykatën e Apelit, duhet theksuar se edhe në mungesë të këtyre treguesve 2 çështje janë gjykuar brenda afatit standard (shih dokumenti 2 dhe 3) dhe vetëm një çështje është në tejkalim të afatit (shih dokumenti 1). Në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimit duhet evidentuar se nga 6 ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës {...} gjatë periudhës së rivlerësimit konstatohen se vetëm 1 ankesë, e vitit 2014, është për zvarritje gjykimi dhe mosrespektimin formal të ligjit, e cila pas verifikimit është arkivuar pasi pretendimet janë gjetur të pabazuara (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore)”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve. Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 1 prej vendimeve të administruar për shkak të ankesave, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.<sup>28</sup>

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (15 çështjet e marra në analizë 6 janë çështje penale themeli dhe 9 çështje civile themeli), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 5 (pesë) çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë 56 ditë ose 1 muaj e 26 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale krime në Gjykatën e Apelit.<sup>29</sup>
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “penale kundërvajtje”, rezulton të jetë 36 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale kundërvajtje në Gjykatën e Apelit.
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 9 (nëntë) çështje në kategorinë e çështjeve “civile të përgjithshme”, rezulton të jetë 124 ditë, rreth 1 muaj e 22 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Apelit.<sup>30</sup>

<sup>28</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se : “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

<sup>29</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ **g.** Gjykimet penale në gjykatën e apelit, jo më tej se 2 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

<sup>30</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “**h.** Gjykimet civile në gjykatën e apelit, jo më tej se 6 muaj”.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar për të gjitha kategoritë e çështjeve të analizuar.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha e kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

## **2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ajo ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim gjithsej 1407 çështje dhe ka përfunduar 960 çështje, duke mbartur vitin e fundit gjithsej 200 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 66.6% (por duhet nënvizuar edhe fakti se për arsye shëndetësore gjyqtarja gjate vitit 2015 nuk ka qenë 2 muaj në punë)”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Apelit Shkodër, të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se gjyqtarja {...} për periudhën 20.12.2013–08.10.2016, paraqet këtë ngarkesë çështjesh, të ndarë për çdo vit kalendarik:

**Për vitin 2013** (08.10.2013-31.12.2013), gjyqtarja ka përfunduar gjykimin në total për 81 çështje, nga të cilat 26 çështje penale, 38 çështje civile, 13 kërkesa penale, dhe 4 kërkesa civile.

**Për vitin 2014** (01.01.2014-31.12.2014), gjyqtarës i janë caktuar për gjykim 549 çështje dhe ka përfunduar gjykimin në total për 399 çështje, nga të cilat 60 çështje penale, 194 çështje civile, 102 kërkesa penale dhe 43 kërkesa civile. Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 72.67%.

**Për vitin 2015** (01.03.2015-31.12.2015), gjyqtarës i janë caktuar për gjykim 500 çështje dhe ka përfunduar gjykimin në total për 254 çështje, nga të cilat 59 çështje penale, 87 çështje civile, 83 kërkesa penale dhe 25 kërkesa civile. Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 50.8%.

**Për vitin 2016** (01.01.2016-08.10.2016), gjyqtarës i janë caktuar për gjykim 358 çështje dhe ka përfunduar gjykimin në total për 251 çështje, nga të cilat 59 çështje penale, 80 çështje civile, 87 kërkesa penale dhe 25 kërkesa civile. Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 70.11%.

Pra, për të gjithë periudhën e vlerësimit rezulton se gjyqtarës i janë caktuar në total 1407 çështje dhe ka përfunduar me vendim deri në tetor 2016, 985 çështje. Referuar rendimentit, sipas këtyre të dhënave, rezulton **një normë likuidimi çështjesh prej 70%**.

Në shpjegimet e paraqitura nga gjyqtarja nëpërmjet postës elektronike në datën 08.02.2022, të depozituara në Këshill me aktin nr. 859 Prot., datë 10.02.2022, gjyqtarja parashtron se *“Gjatë kësaj periudhe vlerësimi kam përballuar një ngarkesë të lartë, ku duhet të theksohet se numri i çështjeve që më janë caktuar, janë vetëm çështjet ku unë kam qenë në cilësinë e relatores, pra nuk janë përfshirë çështjet gjyqësore ku kam qenë me cilësinë e anëtares. Numri i çështjeve që kam gjykuar me cilësinë e anëtares së trupit gjykues, për secilin vit të periudhës së vlerësimit ka qenë shumë i lartë. Përfundim bën vetëm viti 2015, vit në të cilin, për arsye të rënda shëndetësore, e kam patur të pamundur të gjykoj si relatore që nga data 11 Tetor e deri në fund të atij viti kalendarik. Njëkohësisht, duhet të merrni në konsideratë edhe faktin e delegimeve në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, gjatë kësaj periudhe. Një element tjetër që doja të evidentoja është edhe fakti i transferimit apo emërimit në një gjykatë të tjetër, të gjyqtarëve, duke bërë që çështjet e tyre të ndahen me short, duke shtuar ngarkesën në mënyrë të menjëhershme, fakt që ka ndikuar në organizimin e punës. Duke iu referuar të dhënave statistikore, si dhe interpretimit logjik të bazës ligjore të përmendur më lart, mendoj se edhe për këtë kriter nuk duhet të vlerësohem me katër pikë, por me një nivel më të lartë. Në rastet e vendimeve të analizuara për vlerësimin tim profesional, është evidentuar se në përgjithësi seancat e caktuara kanë qenë produktive, duke shmangur shtyrjet e pajustificuara. Por, edhe kur janë shtyrë seancat, ato kanë qenë për shkaqe të pavarura nga ana e gjykatës ose për shkaqe objektive, por asnjëherë për shkak e në përgjegjësi të gjyqtarit e për më tepër të kryesuesit, në cilësinë e të cilit kam qenë unë në këto çështje (me përjashtim të vitit 2015, kur kam qenë në pamundësi shëndetësore për të marrë pjesë në gjykime, ndonëse edhe për këtë vit kam tejkalluar standardin sasior të punës së gjyqtarit të apelit). Gjithsesi, nga projekt-raporti rezulton se në çdo vit kam tejkalluar standardin sasior të punës së gjyqtarit të apelit. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga elementët dhe veprimet e tjera*

*të marra nga unë si kryesuese e kolegjit. Në çdo çështje ku kam qenë në cilësinë e kryesuesit (por edhe si anëtare), kam treguar kujdesin që shpejtësia e gjykimit të mos cenojë të drejtat e palëve në si në procesin civil ashtu edhe në procesin penal, me qëllim garantimin e një mbrojtje sa më efektive për të pandehurit". Bashkëlidhur kundërshtimeve gjyqtarja ka depozituar edhe provat të reja, konkretisht: 1. Evidenca statistikore e ngarkesës individuale të punës së gjyqtarëve për vitin 2016; 2. Evidenca statistikore e ngarkesës individuale të punës së gjyqtarëve për vitin 2015; 3. Evidenca statistikore e ngarkesës individuale të punës së gjyqtarëve për vitin 2014; 4. Evidenca statistikore e ngarkesës individuale të punës së gjyqtarëve për vitin 2013.*

Në Metodologjinë e Pikëzimit përcaktohet se *"Rendimenti i përfundimit të çështjeve është raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar brenda një viti kalendarik"*.

Në lidhje me pretendimin e gjyqtarës për mospërfshirjen në ngarkesën e punës të saj për periudhën e vlerësimit, edhe të çështjeve në të cilat ajo ka qenë në cilësinë e anëtares të trupit gjykues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, rezulton se norma e likuidimit të çështjeve përcaktohet si raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar brenda një viti kalendarik. Pra, në këtë përlllogaritje nuk përfshihen çështjet në të cilat gjyqtarja ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues.

Në kundërshtimet e saj gjyqtarja ka parashtruar se fakt që ka ndikuar në organizimin e punës, gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë delegimi i saj për çështje të caktuara në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, apo çështjet e caktuar me short pas transferimit apo emërimit të gjyqtarëve në gjykata të tjetra, duke ndikuar kështu në rritjen e punës në mënyrë të menjëhershme. Nuk rezulton që në kundërshtimet e parashtruara apo në provat e paraqitura nga gjyqtarja të ketë të dhëna lidhur me numrin e çështjeve të caktuara si e deleguar në Gjykatën e Apelit Vlorë apo në Gjykatën e Apelit Durrës, apo të dhëna lidhur me numrin e çështjeve të caktuara me short pas largimit të gjyqtarëve të tjerë, çka do të ndikonte në përlllogaritjen matematikore të normës së likuidimit të çështjeve gjyqësore.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se vlerësuesi nuk bën vetëm një veprim matematikor për të përcaktuar rendimentin e përfundimit të çështjeve, por ai bazohet edhe në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai nivelit të përqindjes. Ky vlerësim mund të shkojë deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi. Në rastin konkret, rezulton se gjyqtarja {...} për periudhën e vlerësimit ka gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi, konkretisht, ka gjykuar 64% më shumë se standardi sasior i punës. Po kështu, duke pasur parasysh se në përlllogaritjen matematikore të normës së likuidimit të çështjeve, ka ndikuar edhe periudha në të cilën gjyqtarja për arsye shëndetësore ka qenë në



pamundësi për të shqyrtuar çështje, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet dy nivele me lart se ai që i përket përqindjes së pikëzimit.

## **KONKLuzioni**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore vlerësohet në nivelin “Mbi 87-93%”.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” vlerësohet në nivelin “Mbi 87-93%”, duke e pikëzuar me 6 pikë.*

## **2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR**

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykatat<sup>31</sup> lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} i ka arsyetuar vendimet gjyqësore në interval

<sup>31</sup> Informacioni i dërguar nga Gjykata e Apelit Shkodër nëpërmjet postës elektronike në datën 01.04.2021.

*kohor nga 5 ditë (shih dosjen 1 dhe 2) gjer në 18 ditë (shih dosjen 4). 2 vendime janë arsyetuar prej saj jashtë afatit ligjor (shih dosjet 2 dhe 4), ndërsa 3 vendime brenda afatit ligjor (shih dosjet 1, 3 dhe 5). Vendimi që është arsyetuar me vonesën më të lartë prej 18 ditë, ka qenë çështje civile me palë kundërshtare, por nuk rezulton që vonesa të ketë cenuar të drejtën e palës për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e rekursit, pasi nuk ka të dhëna që të jetë ushtruar kjo e drejtë nga palët. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...} ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Në rastet e vëzhguara të përzgjedhura në mënyrë rastësore me short ajo ka respektuar përgjithësisht afatet standarde të gjykimit. Lidhur me kohën e arsyetimit të vendimeve, në 2 raste nga 5 dosje të vëzhguara gjithsej, ka tejkaluar afatin ligjor, por tejkalimi i afatit ka qenë disa ditë dhe në asnjë rast përtej afatit të rekursit”.*

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore, kjo kohë, gjithsesi, nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 30 (tridhjetë) ditor, sipas parashikimeve të nenit 435 pika 1 të K.Pr.Penale, në fuqi para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit penal të gjykatës së apelit, kur palët ishin prezent, fillonte nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Mbështetur në të njëjtin arsyetim, edhe për vendimet civile, K.Pr.Civile (para nëntorit 2017) nuk parashikonte afat procedural, por gjithsesi, ky afat nuk mund të ishte më i gjatë se afati për ushtrimin e të drejtës së rekursit sipas parashikimeve të nenit 443 paragrafi i dytë dhe nenit 476 të K.Pr.Civile. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 30 ditor i rekursit ndaj vendimit penal dhe civil të gjykatës së apelit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja 1, që i përket vendimit penal me nr. 29, datë 23.01.2014, është dorëzuar në datën 28.01.2015 - (5 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 2, që i përket vendimit penal me nr. 194, datë 07.05.2015, është dorëzuar në datën 18.05.2015 - (11 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 3, që i përket vendimit civil me nr. 612, datë 07.11.2013, është dorëzuar në datën 12.11.2013 - (5 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 4, që i përket vendimit civil me nr. 229, datë 16.04.2015, është dorëzuar në datën 04.05.2015 - (18 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 5, që i përket vendimit civil me nr. 16, datë 19.01.2016, është dorëzuar në datën 26.01.2016 - (7 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Apelit Shkodër me shkresën nr. 817 Prot., datë 04.05.2021, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 29.04.2021, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit penal me nr. 319, datë 10.07.2014, është dorëzuar në datën 08.09.2014 - (60 ditë), tej afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 7, që i përket vendimit civil me nr.640, datë 14.11.2013, është dorëzuar në datën 10.12.2013 - (26 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 8, që i përket vendimit civil me nr.343, datë 02.06.2015, është dorëzuar në datën 09.07.2015 - (37 ditë), tej afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 9, që i përket vendimit civil me nr.345, datë 02.06.2015, është dorëzuar në datën 09.07.2015 - (37 ditë), tej afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 10, që i përket vendimit civil me nr.343, datë 22.06.2016, është dorëzuar në datën 29.07.2016 - (37 ditë), tej afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 11, që i përket vendimit penal me nr.180, datë 21.04.2016, është dorëzuar në datën 25.05.2016 - (34 ditë), tej afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë “*civile të përgjithshme*” është 23.8 ditë dhe për kategorinë “*penale krime*” është 27.5 ditë.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE**

### **2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Në 5 dosjet e vëzhguara prej saj është konstatuar se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjet 1, 3, 4 dhe 5), me 2 seanca (shih dosjen 2) dhe me 4 seanca (shih dosjen 3). Ndër 7 seancat gjyqësore të vëzhguara, vetëm një prej tyre ka qenë joproduktive. Pengesë në seancën gjyqësore joproduktive ka qenë mungesa e të pandehurit, për të cilin është urdhëruar njoftimi me policinë gjyqësore (shih dosja 2). Nuk ka patur asnjë seancë të dështuar për shkak të vetë gjyqtarës {...}. Në të gjitha rastet janë marre masat për njoftimin e palëve. Vetëm në një rast është shtyrë seanca për njoftimin e të pandehurit me anë të policisë gjyqësore dhe distanca kohore midis seancave është 14 ditë (kohë e arsyeshme edhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë-shih dosja 2)”.

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtarë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, të administruara në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1 – që i përket çështjes penale, me nr. 133/613 (00322) regjistri, datë regjistrimi 05.09.2013, të përfunduar me vendimin nr.29, datë 23.01.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 2 – që i përket çështjes penale, me nr. 273 (00035) regjistri, datë regjistrimi 09.01.2015, të përfunduar me vendimin nr.194, datë 07.05.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 seancë ka qenë joproduktive, ku shkak për shtyrjen është bërë mosparaqitja e të pandehurit, për shkak të mosmarrjes dijeni për seancën gjyqësore.
- Dosja 3 – që i përket çështjes civile, me nr. 986/1488 (00425) regjistri, datë regjistrimi 18.05.2012, me objekt “Shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror”, të përfunduar me vendimin nr.612, datë 07.11.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 4 – që i përket çështjes civile, me nr. 220/1658 (00260) regjistri, datë regjistrimi 18.04.2014, me objekt “Njohje e pasaktësisë së dokumentit”, të përfunduar me vendimin nr.229, datë 16.04.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për

përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

- Dosja 5 – që i përket çështjes civile, me nr. 583/1252 (00732) regjistri, datë regjistrimi 02.09.2015, me objekt “Pasaktësi e pjesshme e dokumentit”, të përfunduar me vendimin nr.16, datë 19.01.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 – që i përket çështjes penale, me nr. 351 (00142) regjistri, datë regjistrimi 21.03.2014, të përfunduar me vendimin nr.319, datë 10.07.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 7 – që i përket çështjes civile, me nr. 547/968/1448 (00821) regjistri, datë regjistrimi 04.10.2011, me objekt “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”, të përfunduar me vendimin nr.640, datë 14.11.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 8 – që i përket çështjes civile, me nr. 340/1799 (00444) regjistri, datë regjistrimi 02.07.2014, me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”, të përfunduar me vendimin nr.343, datë 02.06.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 9 – që i përket çështjes civile, me nr. 356/1815 (00469) regjistri, datë regjistrimi 16.07.2014, me objekt “Lirim, dorëzim sendi”, të përfunduar me vendimin nr.345, datë 02.06.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 10 – që i përket çështjes civile, me nr. 270/900 (00336) regjistri, datë regjistrimi 17.04.2015, me objekt “Detyrim kthim shume”, të përfunduar me vendimin nr.343, datë 22.06.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproduktive, seanca është shtyrë për shkaqe procedurale, për shpalljen e arsytuar të vendimit.
- Dosja 11 – që i përket çështjes penale, me nr.555 (00407) regjistri, datë regjistrimi 13.05.2015, të përfunduar me vendimin nr. 180, datë 21.04.2016, të Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat 4 (katër) seanca kanë qenë joproduktive, duke u shtyrë për shkak të mosparaqitjes së të pandehurve dhe për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësve të të pandehurve.

Nga tërësia e të dhënave të mësipërme, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 11 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (*penale themeli*

*dhe civile themeli*) varion nga 1, deri në 5 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 1.5 seanca gjyqësore.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve me palë kundërshtare, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore, duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (nenin 460 të K.Pr.Civile dhe nenet 426 dhe 342/2 të K.Pr.Penale). Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Në çdo rast, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimi i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurit, etj. Përgjithësisht, në rastet e shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 11 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 1.5 seanca. Gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore në dosje e analizuara është më i vogël se 3, si dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues konkludohet se: *“Në dy raste vonesat në fillimin e seancave gjyqësore kanë qenë të papërfillshme (shih dosja 1 dhe 3), në dy raste vonesat kanë qenë nga 16 - 37 minuta (shih dosja 2 dhe 5) dhe për një rast nuk ka të dhëna për orën e fillimit të seancës (shih dosjen 4). Vetëm në një rast të fillimit me vonesë të seancës gjyqësore gjyqtari ka relatuar shkakun - mungesa e internetit (shih dosja 5). Megjithatë, vonesa në fillimin e seancave nuk ka penguar ecurinë e gjykimit. Jo të gjitha seancat gjyqësore janë zhvilluar në salle dhe janë dokumentuar me regjistrim audio. Nga 5 dosjet e vëzhguara vetëm tre seanca janë zhvilluar në salle dhe regjistruar audio (shih dosja 2 dhe 5). Gjatë gjykimit, gjyqtarja {...} identifikon veprimet procedurale që duhen kryer, merr mendimin e palëve për to, dhe disponon me vendimet e ndërmjetme. Gjyqtarja {...} përgjithësisht zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Në rastet kur është vendosur gjykimi në mungesë të palës, vendimi ka qenë i arsyetuar dhe përgjithësisht me referencë ligjore (shih dosja 3 dhe 4)”*.

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se të gjitha çështjet i përkasin kategorisë së çështjeve penale dhe civile të përgjithshme me palë kundërshtare.

Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet (*konstatohet se në çështjet penale në asnjë rast nuk është nxjerrë vendimi për caktimin e seancës*) për caktimin e seancës së parë gjyqësore, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve në Apel, konform nenit 460 të K.Pr.Civile dhe nenit 426 e vijues të K.Pr.Penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se përgjithësisht në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët.<sup>32</sup> Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligjin për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë, mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit,

<sup>32</sup> Neni 460/2/5 i K.Pr.Civile dhe neni 426 i K.Pr.Penale

zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 2 deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës dhe përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë, konstatohet se disa seanca kanë filluar me më shumë se 16 minuta me vonesë, deri në 54 minuta me vonesë, nga ora e planifikuar, por në asnjë rast, fillimi me vonesë nuk ka sjellë joproduktivitetin e zhvillimit të seancës gjyqësore. Shkaku i vonesës në zhvillimin e seancës gjyqësore, në rastet kur ai është relatuar nga gjyqtarja, lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo mospasja e sallave të lira për gjykim.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi : Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

## **2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE**

### **2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);



- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short në përgjithësi nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në 5 dosjet të vëzhguara ka akt formal të gjyqtarit relator për thirrjen e palëve në seancën e parë gjyqësore (në çështjet penale), edhe pse seanca e parë gjyqësore është caktuar nga kryetari i gjykatës me listën e shpalljeve të nxjerrë nga ana e tij, në dosje janë administruar aktet e njoftimit të palëve dhe lista e shpalljeve, por në përgjithësi nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes”.

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori.

Renditja e akteve në çështjet penale fillon me aktin procedural të shortit, vijon me njoftimet për palët në rend kronologjik, prapësimet dhe konkluzionet përfundimtare të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e akteve në çështjet civile fillon me aktin procedural të shortit, vijon me njoftimin me shpallje për palët, aktet e përfaqësimit, diskutimet e palëve, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

## 2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short në përgjithësi nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në 5 dosjet të vëzhguara ka akt formal të gjyqtarit relator për thirrjen e palëve në seancën e parë gjyqësore (në çështjet penale), edhe pse seanca e parë gjyqësore është caktuar nga kryetari i gjykatës me listën e shpalljeve të nxjerrë nga ana e tij, në dosje janë administruar aktet e njoftimit të palëve dhe lista e shpalljeve, por në përgjithësi nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal. Në 3 dosje gjyqësore janë inventarizuar aktet procedurale, megjithatë duhet evidentuar se kopjet e dosjeve janë paraqitur në gjykatë nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe një nga gjykata e lartë”.*

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për palët, procesverbalet e çdo seance, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesat për shtyrje të seancës, aktet e përfaqësimit, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk konstatohen mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara (me përjashtim të vendimit për nxjerrjen e çështjes në seancë gjyqësore), apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Në lidhje me mungesën e përfshirjes në dosje të vendimeve të caktimit të seancave gjyqësore në çështjet civile, kjo nuk ka qenë detyrë e gjyqtarit relator, sepse sipas nenit 460 të K.Pr.Civile, para ndryshimeve me ligjin 38/2017, caktimi i datës së gjykimit bëhej nga kryetari i gjykatës. Ishte kryetari ai që përcaktonte çështjet gjyqësore që do të shqyrtoheshin nga secili trup gjykues në apel dhe urdhëronte sekretarinë e gjykatës për njoftimin me shpallje.

### KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, pasi në rastet kur evidentohet mungesa e aktit procedural për nxjerrjen e çështjeve civile për gjykim, kjo nuk ka qenë detyrë e gjyqtarit relator, por e kryetarit të gjykatës. Po kështu, edhe në çështjet penale evidentohet mungesa e aktit

procedural për nxjerrjen e çështjes në gjykim, por pavarësisht kësaj, evidentohet se kjo mungesë nuk ka sjellë asnjë pasojë procedurale në zhvillimin e çështjes dhe përfundimin e saj, pasi gjyqtarja ka marrë masat për njoftimin e palëve për seancën e parë gjyqësore dhe asnjë veprim apo mosveprim nga ana e saj nuk ka ndikuar në zvarritjen apo nuk ka rezultuar në moszhvillimin e seancave gjyqësore efektive.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

### Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	96

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

#### 3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur gjithsej 6 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së (2 në vitin 2013, 3 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016). 1 ankesë e vitit 2016 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes

*apelimit gjyqësor dhe për 5 ankesa të tjera pas verifikimit ka rezultuar se: 2 ankesa të verifikuara bazuar në informacionin periodik të ardhur nga kryetari i gjykatës, në lidhje me mosdorëzimin në afat të vendimeve të arsyetuara, i janë regjistruar gjyqtarës për efekt të vlerësimit profesional dhe etik; 1 ankesë e vitit 2013 verifikuar për mosrespektim formal të ligjit është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara; 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar bazuar në informacionin periodik të ardhur nga kryetari i gjykatës është arkivuar pasi pretendimet janë të pabazuara dhe 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit, është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore”.*

### **3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionet e hartuar nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 327, datë 23.12.2020, KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikojnë në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarës, duke konkluduar se ankesat e kësaj natyre nuk rezultuan as nga denoncimet e drejtpërdrejta pranë Komisionit.

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES**

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.*

#### **3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 6 ankesa (2 në vitin 2013, 3 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD, nga të cilat 4 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se janë ankesa të pabazuara (3 ankesa) dhe me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor (1 ankesa), ndërsa 2 (dy) ankesa të vitit 2013 dhe 2014 janë verifikuar për mosdorëzimin në afat të vendimeve gjyqësore dhe i janë regjistruar gjyqtares për vlerësimin profesional dhe etik. Në materialet për verifikimin e informacionit të dërguar nga kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Komisioni, duke*

pasur parasysh: (i) deklaratet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, “Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratet në seancë dëgjimore, arsyeton se: Nëse analiza financiare do të kryhet për të gjithë familjen së bashku, balanca në fund të vitit kalendarik do të rezultonte pozitive, me përjashtim të vitit 2010 (trajtuar më lart). Në përfundim, Komisioni, pasi analizoi të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet, del në konkluzionin që personat e lidhur kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për përbalimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive”.<sup>33</sup>

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.327, datë 23.12.2020, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarës, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara, duke konkluduar se: “Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Si konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”.<sup>34</sup>

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

## **KONKLUSIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

## **3.C PAANËSIA E GJYQTARES**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga 3 dokumentet ligjore

<sup>33</sup> Faqe 15 e vendimit të KPK nr. 327, datë 23.12.2020.

<sup>34</sup> Faqe 16 e vendimit të KPK nr. 327, datë 23.12.2020.

*të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë gjyqtaren {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar çështje që lidhen me grupet në nevoje, barazinë gjinore apo pakicat. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit”.*

### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja, 2 vendimeve të administruar për shkak të ankesave dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse, të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtares.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendimeve të administruar për shkak të ankesave) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, treguesi “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”***

Niveli i vlerësimit  
KRITERI



ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

#### 4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### 4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit {...} me palët ndërgjyqëse. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.

##### 4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet

shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### **4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me koleget dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 4 prej 5 dosjeve të vëzhguara është konstatuar se bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore përgjithësisht ka qenë në nivelin e duhur, pasi nuk janë konstatuar vonesa domethënëse në depozitimin e dosjes në sekretarinë gjyqësore (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 5)”*.

#### **4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, presumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo për ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, presumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, presumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Për shkak të funksionit që kryen, ajo i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë si eksperte në 12 aktivitete trajnuese (15 ditë) të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe ka qene pjesëmarrëse në 13 aktivitete trajnuese (22 ditë), të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Lënda e trajnimeve lidhet me të drejtën ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, të drejtën administrative, drejtën penale dhe civile”*.

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.3562/3 Prot., datë 11.04.2019, vërtetimit me nr. 573/1 Prot., datë 20.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertes dhe pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e ekspertes në Programin e Formimit Vazhdues në 12 (dymbëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 15 ditë trajnimi;
- (ii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 13 (trembëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 19 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9<sup>35</sup> të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit ka

---

<sup>35</sup> Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :*“Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:*

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 50.5 ditë në të gjithë periudhën e vlerësimit.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

#### **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 28 aktivitete të zhvilluara për 50.5 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese në Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

#### **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarës në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertes në 15 (pesëmbëdhjetë) aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët

---

*Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.*

do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e ekspertes në 15 aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte.

*Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore, mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrje në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit, etj.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nga aktet e dorëzuara nga gjyqtarja bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit profesional, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka qenë bashkëautore në botimin “Manual i etikës gjyqësore”, i botuar nga Shoqata “Unioni i gjyqtarëve të Shqipërisë”, në vitin 2014.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për rrjedhojë, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

*Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” rezulton angazhimi i gjyqtares, prandaj gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”***

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98



**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

<b>Niveli i vlerësimit për çdo kriter</b>		
<b>Kriteri</b>	<b>Pikët</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	96	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	98	Shkëlqyeshëm
<b>Niveli i përgjithshëm i vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	394	Shkëlqyeshëm

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARJAN {...}**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES</b>			
<b>Treguesit</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë</b>
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES</b>			
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	0-10 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të</li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë

		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).	me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Mbi 87-93%
	Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> <li>▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.</li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
<b>B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore</b>	Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore</b>	Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë

	Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
--	---	--	---------------

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
<b>A. Etika në punë</b>	Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>B. Integriteti i gjyqtarës</b>	Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>C. Paanësia e gjyqtarës</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	I pa konsiderueshëm

### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	I lartë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë
	Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë

<b>C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit.	15-120 ditë		
	Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit.	Ka të dhëna		
	Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna		
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit.	Ka të dhëna		
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>		<b>394</b>			
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES</b>		<b>Shkëlqye</b>			

### PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR